



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. 31/17 Prot.

Tiranë, më 28 . 10 .2025

K Ë R K E S Ë

KËRKUES:

Jo më pak se 35 deputetë të Kuvendit të Shqipërisë (jo më pak se 1/4 e deputetëve të Kuvendit)

OBJEKTI:

Ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për kontrollin e ligjshmërisë në administrimin e fondeve të programit IPARD II (Instrumeti i Asistencës së Para-Anëtarësimit për Zhvillimin Rural)

BAZA LIGJORE:

Neni 77 i Kushtetutës së Shqipërisë;
Neni 25 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë;
Ligji nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”, i ndryshuar.

DREJTUAR:

Z. Niko PELESHI

Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

Zoti Kryetar i Kuvendit,

Në datën 9 Prill 2015, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin nr. 37/2015 “Për ratifikimin e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit European për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II)”.¹ Kjo marrëveshje përbënte kuadrin ligjor, mbi të cilin Bashkimi Evropian do të vijonte shpërndarjes e ndihmës financiare për Shqipërinë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Një ndër

¹ <https://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/77a9a825-15d3-4477-8a40-924bbb942692>

instrumentet e mbështetjes financiare përfshinte pikërisht sektorin e bujqësisë nëpërmjet Programit IPARD II.

Në këtë kuadër, në datën 17.03.2016, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin nr. 30/2016 *“Për ratifikimin e Marrëveshjes Sektoriale ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit European, që përcakton dispozitat e menaxhimit dhe zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit në fushën “Bujqësia dhe Zhvillimi Rural” (IPARD)”*.² Kjo marrëveshje parashikonte mbështetje financiare në shumën 94 milionë euro për fermerët shqiptar, ku financimi ndahej në masën 75% nga Bashkimi European dhe 25% nga Qeveria shqiptare.³

Në kuadër të këtij programi, Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR) hapi katër thirrje publike për fermerët shqiptar, ndërsa numri total i përfituesve ishte vetëm 431 persona, përkatësisht 126 përfitues nga thirrja e parë⁴, 173 përfitues nga thirrja e dytë⁵, 144 përfitues nga thirrja e tretë⁶, dhe 34 përfitues nga thirrja e katërt⁷. Numri i ulët i personave që përfituan nga fondet e IPARD II dhe refuzimi i aplikimeve nga fermerë realë ngriti pikëpyetje të mëdha mbi mënyrën e administrimit të këtij programi.

Një fermer nga Erseka, inxhinieri R.N., të cilit iu refuzua aplikimi për ndërtimin e një pemëtorje, paraqiti një ankesë pranë Zyrës Europiane kundër Mashtrimit Financiar (OLAF)⁸. Pas një hetimi gjithëpërfshirës nga zyrtarët evropianë të OLAF, rezultuan disa shkelje shumë serioze qoftë gjatë fazës së dhënies së granteve, ashtu edhe gjatë zbatimit të projekteve. Konkretisht këto shkelje përfshinin: i) aplikantëve u kërkohesh të paguanin një pjesë të konsiderueshme të grantit pranë një kompanie lokale konsulence; ii) kontratat jepeshin pa garë reale ose përmes një gare të

² <https://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/dbfc75ca-dbl3-4892-baf7-beecf34e6685>

³ <https://azhbr.gov.al/programi-ipard/>

⁴ <https://azhbr.gov.al/en/thirrja-1/>

⁵ <https://azhbr.gov.al/thirrja-2/>

⁶ <https://azhbr.gov.al/ipard-3/>

⁷ <https://azhbr.gov.al/ipard-ii-thirrja-e-katert/>

⁸ <https://www.reporter.al/2023/07/25/ruga-e-korrupsionit-prokuroria-dremiti-mbi-dosjen-e-fondeve-te-be-per-bujqesine/>

manipuluar nëpërmjet paraqitjes së ofertave fiktive; dhe iii) çmimet ishin të fryra dhe u shkelën rregullat kontraktuale.⁹

OLAF i rekomandoi Komisionit Evropian që ta konsideronte një pjesë të financimit të thirrjes së parë dhe të dytë për programin IPARD II në shumën 33 milionë euro të papranueshme, çka më pas solli edhe pezullimin e këtyre fondeve. Po ashtu, u pezulluan edhe fondet e programit IPARD III në shumën 112 milionë euro. Pra, si rezultat i shkeljeve shumë serioze të detyrimeve ligjore dhe kontraktuale, të cilat OLAF i konsideroi si “*kriminale*” dhe “*korruptive*”, fermerëve shqiptar iu mohua mundësia për të përfituar 112 milionë euro mbështetje financiare nga Bashkimi Evropian, në kuadër të programit IPARD III, pjesë e Marrëveshjes Kuadër IPA III.

Gjetjet dhe konkluzionet që rezultuan nga hetimi i kryer nga zyrtarët evropianë, OLAF ia përcolli zyrtarisht institucioneve shqiptare, përfshirë edhe Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), për hetime më të thelluara, si dhe për marrjen e masave me qëllim parandalimin e këtyre fenomeneve negative në të ardhmen. Gjatë raportimit në Komisionin e Ligjeve, drejtuesi i SPAK pranoi se aktualisht çështja është nën hetim, në bashkëpunim me prokurorët evropianë.¹⁰ Shkeljet dhe problematikat në administrimin e fondeve IPARD u konfirmuan më pas edhe nga auditimet e kompanive të huaja të kontraktuara nga qeveria shqiptare.

Konkretisht, në Tetor 2024, Ministria e Financave kontrakttoi kompaninë gjermane “FTI Consulting”, e cila përkundrejt vlerës 376.800 Euro, kishte për detyrë të kryentë auditimin e jashtëm (forensic) për të vlerësuar zbatimin e Programit IPARD II (2014-2022) në Shqipëri.¹¹ Sipas përgjigjes zyrtareve që AZHBR i ka kthyer mediave rezulton se numri total i subjekteve të identifikuara për mospërbushje të detyrimeve kontraktuale është 164 subjekte, të cilave iu është kërkuar kthimi i shumës totale 1.468.334.032.82 Lekë ose rreth 15 milionë Euro. Pra, nga 431 përfitues, AZHBR ka pranuar se të paktën 164 subjekte kanë shkelur detyrimet e tyre kontraktuale. Nga kjo listë 86 subjekte kanë kthyer shumën 1.7 milionë Euro,

⁹ https://ec.europa.eu/olaf-report/2023/investigative-activities/preventing-undue-expenditure_en.html#serious-misuse-of-eu-pre-accession-agricultural-funds

¹⁰ <https://telegraf.al/politike/abuzimet-me-fondet-e-ipard-perfituesit-grupe-kriminale-dhe-te-afermit-e-politikanëve/>

¹¹ <https://kapitali.al/nje-firme-gjermane-do-te-audioje-politikanet-dhe-biznesmenet-qe-moren-miliona-euro-nga-ipard-ii>

ndërsa vijojnë procedurat ligjore për 85 subjektet e tjera për kthimin e shumës 13 milionë Euro.

Por, ndryshe nga sa pretendon AZHBR, OLAF dhe Komisioni Evropian kanë konstatuar se vlera e fondeve të shpërndara padrejtësisht vetëm gjatë vitit 2022 është të paktën në shumën e 33.5 milionë Euro.¹² Ndërsa, gjatë vitit 2023, kjo vlerën arrin në shumën e 4.3 milionë Euro.¹³ Diferenca ndërmjet këtyre shifrave mund të shpjegohet me faktin se AZHBR pretendon se shkeljet kanë ndodhur vetëm në fazën e zbatimit të projekteve, ndërsa nga ana e zyrtarëve evropianë është konstatuar se shkeljet kanë ndodhur edhe në fazën e përzgjedhjes së aplikimeve fituese. Megjithatë, përtej shifrave, ajo që vlen në këtë rast të theksohet është fakti se tashmë edhe Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë dhe Agjencia Zhvillimit Bujqësor dhe Rural kanë pranuar se administrimi i fondeve të programit IPARD II ka pasur problematika dhe shkelje, që kërkojnë marrjen e masave për parandalimin e fenomeneve negative në të ardhmen.

Nga investimet e kryera nga mediat shqiptare ka rezultuar se funksionarë publik, familjarë dhe lidhje shoqërore të tyre apo edhe eksponentë të krimit të organizuar kanë përfituar qindra mijëra euro nga fondet e programit IPARD II, duke përforcuar kështu gjetjet dhe konkluzionet e zyrtarëve evropianë.¹⁴

Lista e bërë publike sigurisht nuk është shteruese, por është ilustrim i problematikave dhe shkeljeve të mundshme që ka rezultuar gjatë zbatimit të programit IPARD II, i cili ishte parashikuar për t'iu ardhur në ndihmë fermerëve shqiptar dhe familjeve të tyre, të cilët me shumë punë, mund, djersë dhe sakrifica përpiqen të sigurojnë jetesën e tyre, por që në fakt u shndërrua në një mekanizëm përfitimi dhe pasurimi për zyrtarët publik, familjarët, miqtë e tyre, bizneset e mëdha dhe eksponentë të krimit të organizuar, të cilët më pas këto fonde në të shumtën e rasteve nuk i përdoren për qëllimin për të cilin i kërkuan dhe iu akorduan, por për qëllime të tjera.

Në një intervistë të dhënë së fundmi për revistën “Monitor”, drejtoresha në detyrë e Zyrës Evropiane kundër Mashtrimit Financiar (OLAF), zonja Salla Saastamoinen,

¹² <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52023SC0275>

¹³ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52024SC0193>

¹⁴ <https://www.syri.net/plug/825267/investigimi-nga-motra-e-termet-pecit-te-deputete-e-kryebashkiake-socialiste-plug-zbardh-emrat-e-perfituesve-nga-fondet-ipard/>

është shprehur se gjatë hetimeve të kryera nga ana e tyre për menaxhimin e fondeve të programit IPARD II, atyre iu rezultuan shkelje me financimet e BE-së në Shqipëri. Kjo solli më pas edhe ngrirjen e fondeve të programit IPARD III, të cilat mund të zhblokohen vetëm pasi autoritetet shqiptare të kenë marrë masat e nevojshme për të garantuar se paratë e taksapaguesve evropianë do të përdoren në mënyrën e duhur. Megjithëse, duket se qeveria shqiptare ka filluar marrjen e disa masave, është e rëndësishme që ato të mos mbeten në letër, por të zbatohen në praktikë.¹⁵

Pikërisht, me qëllim kontrollin e zbatimit të Marrëveshjes Kuadër IPA II dhe Marrëveshjes Sektoriale IPARD II, verifikimin e procesit të përzgjedhjes, miratimit dhe financimit të aplikimeve fituese të fondeve IPARD II, analizimin e respektimit të detyrimeve ligjore dhe kontraktuale nga përfituesit e fondeve IPARD II në fazën e zbatimit të projekteve, vlerësimin e veprimeve dhe mosveprimeve të institucioneve përgjegjëse për programin IPARD II, identifikimin e shkeljeve dhe parregullsive të mundshme në administrimin e këtyre fondeve, si dhe vlerësimin e nevojës për ndërmarrjen e masave ligjore, me qëllim parandalimin e fenomeneve negative në të ardhmen, deputetët nënshkruan kërkojnë ngritjen e një Komisioni Hetimor të Kuvendit për Kontrollin e Ligjshmërisë në Administrimin e Fondeve të Programit IPARD II.

Gjykata Kushtetuese e cilëson si “kompetencë kushtetuese” të drejtën e pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar. Duke e veshur një të katërtën e deputetëve me këtë pushtet, Kushtetuta “...institucionalizon një lloj tjetër autoriteti kushtetues, që njihet si pushteti i pakicës parlamentare”, që realizohet “...në mënyrë të pavarur...” dhe që është “...i pakufizuar nga vullneti i shumicës”. E drejta e kontrollit hetimor i është njohur pakicës parlamentare, e cila duke i pasur të kufizuara mjetet në dispozicion, mund ta shndërrojë atë në një instrument të fuqishëm kushtetues.

Ushtrimi normal i veprimtarisë së Kuvendit kërkon ekzistencën e elementeve të domosdoshme që kanë të bëjnë me krijimin e kushteve për respektimin e ligjeve nga të gjitha organet e tjera të pushtetit publik dhe shtetasit, si dhe pajisjen e tij me mjetet e përshtatshme për realizimin e kontrollit mbi mënyrën e zbatimit të ligjeve dhe mbrojtjen e interesit publik.

¹⁵ <https://monitor.al/olaf-fondet-e-ipard-mbeten-te-ngrira-qeveria-te-marre-masa-konkrete/>

Komisionet hetimore që ngrihen për këtë qëllim në kuptim të nenit 77 të Kushtetutës, janë një mjet që i shërben pikërisht ushtrimit të kontrollit parlamentar. Ato janë instrument i rëndësishëm i parlamentit për mbledhjen e informacionit për çështje të veçanta, me qëllim arritjen e përfundimeve të caktuara, që veprojnë vetëm brenda hapësirës kontrolluese të parlamentit e të lidhura në mënyrë funksionale me pushtetin e ligjvënësit.

Qëllimi i Komisionit Hetimor që kërkohet të krijohet mbi bazën e kësaj kërkesë, synon që të mbledhë informacione të hollësishme mbi zbatimin e Marrëveshjeve IPA II dhe IPARD II ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, të miratuara pikërisht nga Kuvendi i Shqipërisë, verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve dhe mosveprimeve të institucioneve dhe zyrtarëve shqiptar gjatë proceseve të përzgjedhjes së aplikimeve dhe zbatimit të projekteve, nxjerrjen e përgjegjësisë institucionale, si dhe vlerësimin e nevojës për miratim, korrigjim, ndryshim të legjislacionit, me qëllim që në të ardhmen të parandalohen pasojat negative që mund të vijnë për shtetin dhe qytetarët shqiptarë, nga shkeljet, parregullsitë dhe abuzimet me ndihmën financiare të akorduar nga Bashkimi Evropian.

Objekti dhe qëllimi i ngritjes së këtij Komisioni Hetimor është në përputhje me Kushtetutën dhe parimet themelore kushtetuese, për shkak se nuk sjell mbivendosje apo transferime të kompetencave të parashikuara nga Kushtetuta për organe të tjera, por synon njohjen dhe verifikimin në hollësi të të gjitha shkeljeve dhe parregullsive që lidhen me administrimin e fondeve të programit IPARD II, me qëllim që të kontrollohet ligjshmëria e veprimeve dhe mosveprimeve të institucioneve shqiptare, të nxirren përgjegjësitë institucionale, si dhe të merren masa të përshtatshme për garantimin e parimeve të ligjshmërisë, integritetit, llogaridhënies dhe transparencës në administrimin e ndihmës financiare të Bashkimit Evropian dhe fondeve publike, në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës dhe mbikëqyrjes parlamentare.

E drejta e Komisionit për kryerjen e hetimeve do të realizohet vetëm brenda funksionit të kontrollit parlamentar dhe detyrave kushtetuese që mbulojnë deputetët, si përfaqësues të popullit dhe avokatë të interesit publik, për zbardhjen e plotë të kësaj çështjeje. Dobishmëria e këtij hetimi konsiston pikërisht në nxjerrjen e

përgjegjësisë institucionale, duke ndihmuar në evidentimin e problemeve dhe mirëfunksionimin e shtetit të së drejtës. Komisioni do të ushtrojë veprimtarinë e tij në përputhje me parimet kushtetuese të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, procesit të rregullt ligjor, prezumimit të pafajësisë, paanshmërisë dhe respektimit të jetës private.

Nëse i referohemi praktikës ndërkombëtare, natyra e çështjeve të hetuara nga komisionet hetimore ka qenë e një rëndësie substanciale apo parësore për publikun, me ndikim të veçantë në marrëdhëniet ndërshtetërore, me qëllim nxjerrjen e përgjegjësiwe institucionale dhe mospërsëritjen e fenomeneve të hetuara në të ardhmen. Në këtë drejtim, çështjet më të shumta kanë pasur për objekt administrimin e fondeve publike, marrëdhëniet ndërshtetërore, falimentimet e korporatave apo subjekteve të ndryshme private, të cilët kanë patur një impakt në ekonominë e vendit, apo hetimin e fenomeneve kriminale.¹⁶

Në rastin konkret, puna e Komisionit Hetimor nuk do të konsistojë në nxjerrjen e përgjegjësiwe penale për personat që potencialisht mund të kenë kryer shkelje, pasi kjo është detyrë funksionale e organeve të drejtësisë. Komisioni Hetimor do të përqendrojë punën e tij në njohjen dhe verifikimin në thellësi të ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga zyrtarët shqiptar gjatë fazës së përzgjedhjes së aplikimeve fituese të fondeve të programit IPARD II, si dhe gjatë fazës së zbatimit të projekteve të miratuara.

Nga ana tjetër, mbledhja e informacioneve të detajuara nga burimet relevante synon që në përputhje me realitetin e diktuar nga rrethanat, provat dhe të dhënat në dispozicion, të nxirren përfundime mbi nevojën e miratimit, plotësimit apo korrigjimit të ligjeve të veçanta, me qëllim ofrimin e një mbrojtjeje të plotë ligjore dhe institucionale të parimeve të ligjshmërisë, integritetit, llogaridhënies dhe transparencës në administrimin e ndihmës financiare të Bashkimit Evropian dhe fondeve publike, në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës dhe mbikëqyrjes parlamentare.

Kërkesa për ngritjen nga Kuvendi të një komisioni hetimor, përmbush tri kriteret kushtetuese si vijon:

¹⁶ Vendimi Nr. 18/2003 i Gjykatës Kushtetuese;

- (i) çështja ka të bëjë me funksionin ligjvënës dhe funksione të tjera për të cilat ai është i autorizuar të marrë masa ligjore;
- (ii) objekti i hetimit fokusohet në një çështje konkrete; dhe
- (iii) ekzistojnë të dhëna dhe indicie të mjaftueshme që dëshmojnë për ekzistencën e problematikave dhe dyshimeve të arsyeshme lidhur me ligjshmërinë e veprimeve dhe mosveprimeve të institucioneve dhe zyrtarëve shqiptar në administrimin e fondeve të programit IPARD II.

Kërkesa për ngritjen e Komisioni Hetimor të Kuvendit për Kontrollin e Ligjshmërisë në Administrimin e Fondeve të Programit IPARD II, bazohet në nenin 77, pika 2 e Kushtetutës, i cili parashikon se: *“Kuvendi ka të drejtë dhe, me kërkesë të një së katërtës së të gjithë anëtarëve të tij është i detyruar të caktojë komision hetimi për të shqyrtuar një çështje të vecantë.”*, si dhe neni 25 i Rregullores së Kuvendit, i cili parashikon se *“1. Kuvendi ka të drejtë dhe, me kërkesën e një së katërtës së të gjithë anëtarëve të tij, është i detyruar të caktojë një komision hetimi, për të shqyrtuar një çështje të veçantë. 2. Komisionet hetimore të Kuvendit veprojnë sipas procedurës së parashikuar me ligj.”*

Prandaj, duke pasur parasysh sa më sipër, ne, një grup deputetësh, jo më pak se 1/4 e anëtarëve të Kuvendit të Shqipërisë, bazuar në nenin 77, pika 2 të Kushtetutës dhe nenin 25, pikat 1 dhe 2 të Rregullores së Kuvendit,

KËRKOJMË:

1. Ngritjen e një Komisioni Hetimor të Kuvendit për Kontrollin e Ligjshmërisë në Administrimin e Fondeve të Programit IPARD II (Instrumenti i Asistencës së Para-Anëtarësimit për Zhvillimin Rural).

2. Komisioni ka për objekt të veprimtarisë së tij:

- (i) Kontrollin e zbatimit të Marrëveshjes Kuadër IPA II dhe Marrëveshjes Sektoriale IPARD II ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian;
- (ii) Verifikimin e procesit të përzgjedhjes, miratimit dhe financimit të aplikimeve fituese të fondeve të programit IPARD II;

(iii) Analizimin e respektimit të detyrimeve ligjore dhe kontraktuale nga përfituesit e fondeve IPARD II në fazën e zbatimit të projekteve;

(iv) Identifikimin e shkeljeve dhe parregullsive të mundshme në administrimin e fondeve të programit IPARD II, si dhe nxjerrjen e përgjegjësive institucionale;

(v) Vlerësimin e nevojës për marrjen e masave, përfshirë ndërhyrjet ligjore nëpërmjet miratimit, korigjimit apo plotësimit të legjislacionit relevant për garantimin e parimeve të ligjshmërisë, integritetit, llogaridhënies dhe transparencës në administrimin e ndihmës financiare të Bashkimit Evropian dhe fondeve publike, në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës dhe mbikëqyrjes parlamentare.

(vi) Të angazhohet për të propozuar për miratim të gjitha masat e nevojshme ligjore që të shmangen në të ardhmen situatat e evidentuar në raportin e hetimit të Zyrës së Bashkimit Evropian kundër Mashtrimeve (OLAF), dhe që mbrojnë interesat financiare të BE-së nga aktivitetet ilegale, duke propozuar masat konkrete që janë të nevojshme që institucionet përgjegjëse të Bashkimit Evropian të rekomandojnë zhbllokimin e fondeve për Shqipërinë për programin IPARD III.












3. Komisioni do të përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë, nga të cilët kryetari dhe katër anëtarë i përkasin Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dhe gjashtë anëtarë Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste.











4. Komisioni e ushtron veprimtarinë për një afat 6-mujor nga data e miratimit të këtij vendimi.





Bashkëlidhur gjeni projektvendimin për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit.


Duke ju falnderuar për mirëkuptimin, kërkojmë vijimin e procedurës parlamentare për ngritjen e Komisionit Hetimor,

D E P U T E T Ë T:

NR.	EMËR MBIEMËR	NËNSHKRIM
1.	GAZMENT BARDHI	
2.	Sead Beusko	
3.	Elda Hoti	
4.	Ena Zhupa	
5.	Jacir Tebokun	
6.	Kastriot Stroli	
7.	Bledar Nollburi	
8.	Luciano Bosi	
9.	Qerd Bylykbusha	
10.	ISUF QEKU	
11.	Alban Volski	
12.	Spas Bekmerkez	
13.	Eni Koso	
14.	Bonelli Spodina	

15.	Mhela Mzei	
16.	Alvin Bollu	
17.	Tomor Alizoti	
18.	BELIND KELLIQI	
19.	JOSEFUA TOPELLI	
20.	Luani Bae	
21.	Flamuri Hoxhe	
22.	Ledina Aloli	
23.	Arson Nolezi	
24.	Eno Bozo	
25.	Hamun Noka	
26.	Ajron Germarkov	
27.	Zija' Ismaili	
28.	Blodiana Lajja	
29.	Lyeta Beroleli	

30.	Sgei cara	
31.	ERISA X HIXHO	
32.	Brunilda Hoxhiu	
33.	Vangel Dine	
34.	Klot HBA	
35.	Ramona Llesj	
36.	Manjda Luter	
37.	Saimir Konedu	
38.	Artan Luter	

39. Berrut Kufci
40. Jiri Jomir
41. Cedmond Naumost
42. Denice Varda
43. Teodi Bluxhi
44. Edi PALORA
45. plendi firangi
- 



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Projekt

VENDIM

Nr. ____/2025

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT
PËR KONTROLLIN E LIGJSHMËRISË NË ADMINISTRIMIN
E FONDEVE TË PROGRAMIT IPARD II (INSTRUMENTI I
ASISTENCËS SË PARA-ANËTARËSIMIT NË ZHVILLIMIN
RURAL)**

Në mbështetje të nenit 77, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

I. Ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për Kontrollin e Ligjshmërisë në Administrimin e Fondeve të Programit IPARD II (Instrumenti i Asistencës së Para-Anëtarësimit për Zhvillimin Rural).

II. Komisioni Hetimor ka për objekt të veprimtarisë së tij:

- (i) Kontrollin e zbatimit të Marrëveshjes Kuadër IPA II dhe Marrëveshjes Sektoriale IPARD II ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian;
- (ii) Verifikimin e procesit të përzgjedhjes, miratimit dhe financimit të aplikimeve fituese të fondeve të programit IPARD II;

- (iii) Analizimin e respektimit të detyrimeve ligjore dhe kontraktuale nga përfituesit e fondeve IPARD II në fazën e zbatimit të projekteve;
- (iv) Identifikimin e shkeljeve dhe parregullsive të mundshme në administrimin e fondeve të programit IPARD II, si dhe nxjerrjen e përgjegjësive institucionale;
- (v) Vlerësimin e nevojës për marrjen e masave, përfshirë ndërhyrjet ligjore nëpërmjet miratimit, korigjimit apo plotësimit të legjislacionit relevant për garantimin e parimeve të ligjshmërisë, integritetit, llogaridhënies dhe transparencës në administrimin e ndihmës financiare të Bashkimit Evropian dhe fondeve publike, në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës dhe mbikëqyrjes parlamentare;
- (vi) Të angazhohet për të propozuar për miratim të gjitha masat e nevojshme ligjore që të shmangen në të ardhmen situatat e evidentuar në raportin e hetimit të Zyrës së Bashkimit Evropian kundër Mashtrimeve (OLAF), dhe që mbrojnë interesat financiare të BE-së nga aktivitetet ilegale, duke propozuar masat konkrete që janë të nevojshme që institucionet përgjegjëse të Bashkimit Evropian të rekomandojnë zhblokimin e fondeve për Shqipërinë për programin IPARD III.

III. Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese, veçanërisht parimin e ndarjes së pushteteve, duke mos iu mbivendosur punës së organeve të drejtësisë, parimin për një proces të rregullt ligjor, parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin e paanshmërisë dhe respektimit të jetës private të individit.

IV. Komisioni Hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi, bashkë me raportin përfundimtar i paraqet Kuvendit në seancë plenare rekomandime në lidhje me nxjerrjen e përgjegjësive institucionale, miratime, ndryshime apo korigjime ligjesh që ofrojnë mbrojtje dhe garanci për parimet e ligjshmërisë, integritetit, llogaridhënies dhe transparencës në administrimin e ndihmës financiare të Bashkimit Evropian dhe fondeve publike, në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës dhe mbikëqyrjes parlamentare.

V. Komisioni Hetimor do të përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë, nga

të cilët kryetari dhe katër anëtarë i përkasin Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dhe gjashtë anëtarë Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste. Përbërja e Komisionit do të jetë si më poshtë:

1. _____ - Kryetar (PD)
2. _____ - Zëvendëskryetar (PS)
3. _____ - Anëtar (PD)
4. _____ - Anëtar (PD)
5. _____ - Anëtar (PD)
6. _____ - Anëtar (PD)
7. _____ - Anëtar (PS)
8. _____ - Anëtar (PS)
9. _____ - Anëtar (PS)
10. _____ - Anëtar (PS)
11. _____ - Anëtar (PS)

VI. Komisioni Hetimor do të zhvillojë veprimtarinë e tij në një afat kohor 6- mujor, nga data e miratimit të këtij vendimi. Në rast nevojë, me kërkesë të arsyetuar të kryetarit, Kuvendi vendos zgjatjen e afatit të ushtrimit të veprimtarisë së komisionit.

VII. Ngarkohen Kryetari i Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm për krijimin e kushteve të punës dhe mbështetjen logjistike të veprimtarisë së këtij Komisioni Hetimor.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Niko PELESHI

Miratuar në datën _____._____.2025